

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE MBRETËRISË SË BASHKUAR TË BRITANISË SË MADHE E IRLANDËS SË VERIUT, QË PLOTËSON KONVENTËN EVROPIANE PËR EKSTRADIMIN, TË VITIT 1957”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Këshilli i Ministrave, me vendimin nr.267, datë 29.3.2017, miratoi, në parim, marrëveshjen, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe e Irlandës së Veriut, që plotëson Konventën Evropiane për Ekstradimin, të vitit 1957.

Ministria e Drejtësisë, mbështetur në pikën 2, të nenit 17, të ligjit nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, ka hartuar projektligjin i cili ka për qëllim ratifikimin e marrëveshjes, të nënshkruar në datën 5 prill 2017, në Tiranë.

Objektivat kryesorë të kësaj marrëveshjeje janë:

- a) plotësimi i dispozitave të Konventës Evropiane për Ekstradimin, (në vijim KEE) e 13 dhjetorit 1957;
- b) lehtësimi i funksionimit të KEE-së ndërmjet shteteve kontraktuese, në mënyrë të veçantë, në lidhje me ekstradimin e shtetasve të tyre përkatës;
- c) eliminimi i pengesave ligjore ndaj ekstradimit të shtetasve të shtetit të kërkuar, të kërkuar për ndjekje penale, ose për kryerjen e një dënimi në shtetin kërkuar, duke marrë masa për ekstradimin e këtyre shtetasve.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Miratimi i kësaj marrëveshjeje është në përputhje me politikat e qeverisë shqiptare, për t’u angazhuar intensivisht në konsolidimin dhe zhvillimin marrëdhënies juridiksionale me autoritet e huaja, në drejtim të përmirësimit dhe lehtësimit të procedurave të bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar.¹ Një

¹ Strategjia Ndërsektorale për Luftën kundër Krimit të Organizuar, Trafiqeve të Paligjshme dhe Terrorizmit, 2013-2020.

qasje e tillë synon, ndër të tjera, nënshkrimin e marrëveshjeve dypalëshe me vendet e rajonit, vendet e Bashkimit Evropian dhe më gjerë.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Instituti i Ekstradimit konsiderohet si një nga format më të arrira të bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën penale, nëpërmjet së cilit mundësohet ndihma e ndërsjelltë e shteteve palë, dorëzimi dhe vënia përpara drejtësisë e shtetasve të larguar nga vendi i kryerjes së veprës penale, me qëllim gjykimin e tyre ose ekzekutimin e një vendimi penal përfundimtar.

Marrëdhëniet e ekstradimit ndërmjet shteteve evropiane rregullohen, kryesisht, nga Konventa e Këshillit të Evropës “Mbi ekstradimin”, e vitit 1957, me katër protokollat shtesë të saj dhe nga marrëveshje dypalëshe.

Aktualisht, Republika e Shqipërisë nëpërmjet ligjit nr.8322/1998, ka ratifikuar konventën e mësipërme (së bashku me katër protokollat shtesë të saj) me rezervë, për mosekstradimin e shtetasve shqiptarë. Kështu, shteti shqiptar refuzon ekstradimin e shtetasve të vet, me përjashtim të rasteve kur është parashikuar ndryshe në marrëveshje ndërkombëtare, ku Shqipëria është palë.² Për këtë arsye, në rastin kur personat që gëzojnë shtetësinë shqiptare kryejnë një veprë penale jashtë territorit të vendit tonë dhe kapen në Shqipëri, ndaj tyre do të aplikohet procedimi sipas nenit 6, të Kodit Penal, në të cilin parashikohet se: “Ligji penal i Republikës së Shqipërisë është i zbatueshëm edhe për shtetasin shqiptar për kryerje krimi në territorin e një shteti tjetër ku krimi është njëkohësisht i dënueshëm dhe derisa nuk është dhënë për të një vendim përfundimtar nga një gjykatë e huaj”.

Nëpërmjet nënshkrimit të marrëveshjes me Mbretërinë e Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut, është propozuar tejkalimi i barrierës ligjore për refuzimin e ekstradimit të shtetasve shqiptarë në shtetet palë të marrëveshjes.

Një propozim i tillë ka rezultuar nga administrimi i të dhënave të deritanishme statistikore, nëpërmjet së cilave tregohet një numër më i lartë i ekstradimit të shtetasve shqiptarë jashtë vendit, në krahasim me ekstradimin e shtetasve britanikë në Shqipëri.

Gjithashtu, propozimi për të shfuqizuar aplikimin e parimit të mosekstradimit të shtetasve shqiptarë, mbështetet edhe në faktin që:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë nuk e përjashton, në mënyrë eksplicite, ekstradimin e bashkëkombësve.

² Shih nenin 6, pika 1, shkronja "a", Konventës Evropiane Për Ekstradimin

- Rregulli aktual i mosekstradimit për këta shtetas, rrezikon t'i shërbejë mosdënimit të disa keqbërësve, për të cilët vendi i origjinës nuk është kompetent për t'i gjykuar. Kjo është dhe arsyeja që Britania e Madhe pranon t'i dorëzojë shtetasit e saj (legjislacioni anglez nuk lejon që të gjykohen shtetasit e tij, të cilët kanë kryer vepra penale jashtë vendit, me përjashtim të vrasjeve).
- Nëse shteti i kërkuar pranon t'i gjykojë vetë shtetasit e vet, në zbatim të parimit të Grotusit, gjykimi i një shtetasi për një vepër të kryer jashtë vendit shpesh nuk është i përshtatshëm, sepse gjykimi më i drejtë mund të jepet vetëm nga shteti kërkuar.

Sa më sipër, në kuadër të përmirësimit të klimës në drejtësi, si dhe bazuar në faktin se aktualisht, të gjitha shtetet evropiane kanë përvetësuar të njëjtat parime të përmbajtjes dhe procedurës së ushtrimit të ndjekjes penale, lind domosdoshmëria e ritrajtimit nga ana e shtetit shqiptar, kundrejt shtetasve të tij, që kryejnë vepra penale në Mbretërinë e Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektkligji i propozuar është në përputhje nenet 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Bashkimi Evropian, si një organizatë shumë e rëndësishme konsiston në adoptimin e standardeve evropiane dhe në mbrojtjen e vlerave në legjislacionet nacionale, ç'ka mund të konsiderohet si proces i evropianizimit. Ndër prioritetet e këtij procesi, përfshihet edhe mbrojtja e njëjtë e lirive dhe e të drejtave individuale në fushën e së drejtës penale, pa marrë parasysh se në cilin shtet gjendet personi.

Legjislacioni (*Acquis*) i BE-së, mbi drejtësinë dhe çështjet e brendshme, bazohet mbi parimet e përgjithshme që rrjedhin nga Traktati i Bashkimit Evropian, Traktati i Funkcionimit të Bashkimit Evropian, si dhe nga jurisprudenca e Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian. Për pasojë, fushat e mbuluara nga *Acquis*, përfshijnë ndër të tjera, edhe marrëveshjet e ekstradimit ndërmjet shteteve anëtare.

Në këtë kuadër, Plani Kombëtar për Integrimin Evropian 2016 – 2020, duke iu referuar Strategjisë Ndërsektoriale për Luftën kundër Krimit të Organizuar,

Trafikeve të Paligjshme dhe Terrorizmit 2013-2020, përcakton angazhimin e qeverisë shqiptare për zbatimin “në gjerësi dhe thellësi, të reformave në sistemin e drejtësisë, të sugjeruara dhe të mbështetura nga partneret ndërkombëtarë (...)në përputhje me angazhimet dhe detyrimet që rrjedhin nga zbatimi i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (Neni 1, 2, 13, 70 dhe 78 i MSA-së).”

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Ekstradimi përbën një instrument tradicional të bashkëpunimit ndërkombëtar, i cili konsiston në dorëzimin e një personi nga shteti në të cilin ai gjendet, në shtetin tjetër që duhet ta gjykojë (ekstradim njohës), ose për ekzekutimin e një dënimi tashmë të dhënë (ekstradim ekzekutiv). Pika 2, e neni 39, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikon se: “Ekstradimi mund të lejohet vetëm kur është parashikuar shprehimisht në marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat Republika e Shqipërisë është palë, dhe vetëm me vendim gjyqësor.” Më tej, kuptimi, kushtet dhe kriteret e ekstradimit, si element i rëndësishëm i bashkëpunimit ndërkombëtar në çështjet penale, rregullohen nga nenet 488-504 të Kodit të Procedurës Penale.

Gjithashtu, nëpërmjet ligjit nr.8322, datë 2.4.1998, Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës për Ekstradimin, të datës 13 dhjetor 1957 dhe protokolleve shtesë të saj, përkatësisht të 15 tetorit 1957 dhe të 17 marsit 1978, me deklaratimet dhe rezervat që parashikohen në këtë ligj, duke refuzuar ekstradimin e shtetasve të vet, me përjashtim të rasteve kur është parashikuar ndryshe në marrëveshje ndërkombëtare, ku Shqipëria është palë.

Aktualisht, bashkëpunimi me Mbretërinë e Bashkuar për çështjet e ekstradimit rregullohen nga Konventa e Këshillit të Evropës “Mbi ekstradimin”, e vitit 1957 ku të dyja shtetet tona janë palë.

Ndërkohë që, nisur nga fakti i rritjes së numrit të veprave penale të kryera së fundmi në territorin e Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut nga ana e shtetasve shqiptarë, si dhe tentativave të shumta të subjekteve të tillë për t’iu shmangur përgjegjësisë penale, nga ana e këtij shteti është propozuar marrëveshja për heqjen e barrierës ligjore që kufizon detyrimin e ekstradimit për vendin tonë.

Marrëveshja e mësipërme parashikon në nenin 1 të saj, se palët nuk do të refuzojnë ekstradimin e shtetasve dhe se neni 6 (1) (a) i Konventës Evropiane të Ekstradimit nuk do të zbatohet.

Në nenin 2 të saj, rregullohet procedura e ekstradimit dhe përcaktohet se, kërkesat për ekstradim komunikohen drejtpërdrejt ndërmjet autoriteteve qendrore që janë Ministria e Drejtësisë për shtetin shqiptar dhe Ministria e Punëve të Brendshme për autoritetet britanike.

Në nenin 3, “Zbatimi i përkohshëm” parashikohet se, kjo marrëveshje nuk ka efekt prapaveprues për kërkesat e ekstradimit të paraqitura përpara datës së hyrjes në fuqi të saj, por do të jetë e zbatueshme për veprat penale të kryera para dhe pas hyrjes në fuqi të marrëveshjes, si dhe nuk do të zbatohet në rast se marrëveshja shfuqizohet.

Ndërsa në nenin 4, rregullohet aplikimi territorial i marrëveshjes për Shqipërinë dhe Mbretërinë e Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut. Elementët e lartpërmendur, do të gjejnë aplikim vetëm në rast respektimi të parimit të reciprocitetit ndërmjet palëve të marrëveshjes.

Sa më sipër, nënshkrimi i marrëveshjes objekt shqyrtimi, ka rezultuar për shkak të shfaqes së vullnetit të mirë të përbashkët të shteteve palë, për të parandaluar kriminalitetin, pavarësisht përkatësisë së personit që përfshihet në shkelje të tilla. Për më tepër, kjo marrëveshje është konceptuar me qëllim për t’i shërbyer dhe për të plotësuar Konventën Evropianë “Mbi ekstradimin”, dhe jo për të dalë tej kornizave të saj, në përputhje të plotë edhe me parashikimet e bëra në këtë Konventë.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Autoriteti qendror, nëpërmjet të cilit kalon e gjithë procedura e ekstradimit, është Ministria e Drejtësisë.

VII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Marrëveshja është hartuar mbi bazën e propozimeve të autoriteteve britanike dhe është përkthyer e çertifikuar nga Ministria e Drejtësisë, e cila më pas e ka dërguar për konsultim të brendshëm pranë:

- Ministrisë së Punëve të Jashtme;
- Ministrisë së Punëve të Brendshme;
- Ministrin të Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin;
- Ministrisë së Financave;
- Ministrisë së Integritimit Evropian;
- Prokurorit të Përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Në projektligj nuk parashikohen efekte financiare.

KËSHILLI I MINISTRAVE